



LOCAL NON-GOVENMENTAL ORGANISATION
"VOICE OF ROMA, ASHKALI AND EGYPTIANS"



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

| | | |
|--------------------|---------------|--------------------|
| Planuar më: | 29.05.2020 | |
| Primjeto: | 29.05.2020 | |
| Mjesia Jedinita | Numri Brej | Shtojca Dodatak |
| 1-360-19866 | | |

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur më dt 29.05.2020, në mes:

"Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve" (Voice of Roma, Ashkali and Egyptians) si Organizatë Joqeveritare me numër të regjistrimit **5113364-1**, me adresë në rrugën "Milosa Obilica" Street në Graçanicë, 10500 Prishtinë, të cilën e përfaqëson Drejtori Ekzekutiv z. **Isak Skenderi**, dhe Komunës së Lipjanit, i përfaqësuar nga z. **Imri Ahmeti** si Kryetar i Komunës.

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

Përkrahje në Hartimin e PLANIT TRE VJEQAR TE BANIMIT 2020-2023 për Komunën e Lipjanit.

Neni 2

Kushtet e përgjithshme të të dyja palëve

OJQ VoRAE zotohet se do të :

- 2.1. Do të sigurojë përkrahje tenike me ekspertët nga lëmia e banimit për draftimin dhe përgaditjen e dokumentit të PLANIT TRE VJEQAR TE BANIMIT.
- 2.2. Trajnimin në bazë të nevojës së paraqitur për anëtarët e grupit punues të Komunës së Lipjanit nga eksperti.
- 2.3. Kontraktimin e ekspertit për të përkrahur procesin e hartimit të PLANIT TRE VJEQAR TE BANIMIT.
- 2.4. Organizimin e takimeve i cili bazohet në bazë të progresit të punës gjatë hartimit të PLANIT TRE VJEQAR TE BANIMIT.
- 2.5. Monitorimin e procesit të punës nga fillimi i procesit deri në finalizim të dokumentit.
- 2.6. Mbështetje procesit për mbledhjen e të dhënave nga tereni për gjendjen aktuale të banimit, me fokus të veçantë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian që jetojnë në Komunën e Lipjanit.
- 2.7. Informimin e qytetarëve të Komunës së Lipjanit dhe organizimin e ndëgjimeve publike të PLANEVE TRE VJEQARE TE BANIMIT.

Komuna e Lipjanit zotohet se do të :

- 2.1.1. Do të autorizoj grupin punues për hartimin e PLANIT TRE VJEQAR TE BANIMIT.
- 2.2.2. Do të ofroj mbështetje teknike në bashkëpunim me organizatën VoRAE.
- 2.2.3. Do të siguroj hapsirën për grupet punuese të cilat do të jenë pjesë e hartimit të këtij dokumenti.
- 2.2.4. Do të përfshijë në grupin punues përfaqësues të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.



LOCAL NON-GOVENMENTAL ORGANISATION
"VOICE OF ROMA, ASHKALI AND EGYPTIANS



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

- 2.2.5. Do të siguroj sallën apo hapsirën fizike për të organizuar ndëgjimet publike të PLANIT TRE VJEQAR TE BANIMIT.
- 2.2.6. Do të jetë përgjegjëse për ta prezentuar dhe marr aprovimin nga Asambleja Komunale e Komunës së Lipjanit.
- 2.2.7. Do të jetë përgjegjëse për të shtypur dokumentin pas finalizimit në kopje të mjaftueshme, në bazë të nevojës.
- 2.2.8. Do të bëj promovimin dhe publikimin e PLANIT TRE VJEQAR TE BANIMIT në faqën zyrtare të Komunës, media vizuale, të shkruar, FB dhe të tjera.

Neni 3

Veprimet konkrete të Komunës së Lipjanit

- 3.1. Grupi punues i Komunës së Lipjanit i autorizur nga Kryetari Imri Ahmeti do të bashkëpunojnë ngusht me përfaqësuesit e VoRAE-së deri në finalizim të PLANIT TRE VJEQAR TE BANIMIT.
- 3.2. Komuna e Lipjanit do të angazhoj persona të fushës përkatëse që do të përfshihen në realizimin e PLANIT TRE VJEQAR TE BANIMIT.

Neni 4

Veprimet konkrete të OJQ VoRAE

- 4.1. Organizata VoRAE obligohet që pikat e lartë cekura të kësaj marrëveshjeje ti përmbahet me përpikmëri dhe ti përgjigjet kërkesave deri në finalizim të dokumentit.
- 4.2. Të ofroj transparencë të plotë ndaj grupit punues, Komunës së Lipjanit dhe qytetarëve.

Neni 5

Kohëzgjatja

- 5.1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit dhe është valide deri në dorëzimin e dokumentit final.

Neni 6

Kushtet e Veçanta

- 6.1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është e plotëfuqishme që nga 29.05 2020 deri në 31.12.2020
- 6.2. Kjo marrëveshje është bërë në dy kopje origjinale për secilën palë nga një formë.


PALËT NËNSHKRUESE

Voice of Roma Ashkali and Egyptians – VoRAE
Drejtore EKZEKUTIVE

Komuna e Lipjanit
Kryetari i Komunës



LOCAL NON-GOVENMENTAL ORGANISATION
"VOICE OF ROMA, ASHKALI AND EGYPTIANS



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

z. Isak SKENDERI

PER: *V. V.*

v.v



29.05..... 2020

